

## Statuti Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “AdVision ALBANIA” Sh.p.k.

### Në këtë statut

- “Ligji është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë;

### Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

#### Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

(1) Sot, me datë 01.07.2021, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin AdVision ALBANIA SH.P.K.

(2) Themeluesit e shoqërisë janë (mbiemrat, emrat ose forma dhe emri ligjor i shoqërisë; adresa ose selia e numri dhe vendi i regjistrimit):

- Enea Toli Koka, lindur në Kuçovë me datë 20.10.1995, dhe banues në Kuçovë me adresë, mbajtës i Kartës së Identitetit Nr. 031946564;
- Endri Agim Karalli lindur në Gjirokastër me datë 08.08.1995, dhe banues në Tiranë me adresë Rr. “Abdyl Matoshi”, Don Bosko, mbajtës i Kartës së Identitetit Nr. 032636600.
- Grisilda Shefqet Selfaj lindur në Tiranë me datë 05.01.1996 dhe banuese në Tiranë me adresë Rr. “Siri Kodra”, Shkalla 2, Apartamenti Nr.18, mbajtëse e Kartës së Identitetit Nr.032492216.

#### Neni 2:

Objekti

Rruga “Abdyl Matoshi”, Kompleksi ICE, Don Bosko, Tiranë,  
Shqipëri | info@advision.al | www.advision.al

Faqja 1

## Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Projektim, zbatim dhe konsulencë për projektet e fushës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, inxhinierisë elektrike, elektronike dhe informatike; Konsulencë, projektim, zbatim, menaxhim, mirëmbajtje dhe auditimin e sistemeve elektronike, informatike dhe të komunikimit, sistemeve të informacionit dhe komunikimit radio, telefonisë, sistemeve radio-radar dhe teknologji te tjera të informacionit të ngjashme në funksione dhe teknika. Projektim menaxhim, mirëmbajtje dhe auditimin konsulencë për menaxhim projektesh TIK si dhe shërbimesh e parë në fushën e programimit të software-ve, Forensic, parandalimin e humbjes së të dhënave dixhitale etj.

Shit-blerje e prodhim programesh/softwaresh të llojeve dhe tipeve të ndryshme në teknologjite WEB, Server Klient, Aplikimeve për Mobile, software GIS, Sisteme të tjera informatike.

Ndërtimi i faqeve Web dhe dizajn grafik.

Shitje, blerje dhe tregtim i artikujve, pajisjeve softwareve shërbimeve në lidhje me fushën e teknologjisë; sistemeve të sigurisë, trajnime në fushat e sipërmendura.

Përfaqësi dhe rishitje të produkteve të ndryshme software dhe hardware të kompanive të ndryshme prodhuese të teknologjive të informacionit, telekomunikacionit, informatike/elektronike.

Shitja e blerja e pajisjeve TI - Teknologjisë së informacionit të tillë si kompjutera, laptopë, servera, projektorë, kamera dixhitale, skaner, printerë, fotokopje, pajisje rrjeti UPS dhe Inverter përfshire pjesë këmbimit për të gjitha llojet e pajisjeve të tillë dhe realizimi i shërbimit të mirëmbajtjes, garancisë e të riparimit.

Blerja dhe shitja e pjesëve për riparimin e printerave, fotokopjeve dhe skanerëve.

Blerja dhe shitja e tonerave, drum-ëve për printer, fotokopje.

Shërbime, blerja dhe shitja e materialeve elektrike.

Shërbime, blerja dhe shitja e materialeve hidraulike.

Sherbime, blerja dhe shitja e kondicionerëve, sistemeve të ajrimit.

Konsulencë, Projektim, Realizimi i instalimit të rrjeteve kompjuterike, informatike. Sistemeve të Survejimit me Kamera si edhe mirëmbajtjen e tyre. Sisteme videoconference, sisteme akses Kontrolli, printime karta aksesi të personalizuara, si dhe sisteme cetonofie dhe video-cetefoni.

Shit-blerje dhe dhënie me qira paisjesh monitorimi GPS, sensora për nivelin e karburantit, mirëmbatje dhe trajnim.

Pajisje për zbulim dhe dezinfektim.

Zhvillim dhe Implementim Sistem Rradhe, Sistenie Infokioske, Dizenjim dhe Zbatim Server Room, Datacenter (Dhënia me qera e Pajisjeve Elektronike si Printer, Fotokopje, Desktop, Laptop, Server, etj Sistenie telefonie VOIP PBX, Elastix, Linux. Telefoni analoge, shitje telefona IP, analog, dixhital.

**Neni 3**

**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë data e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për një përiudhë të pacaktuar.

**Neni 4**

**Selia**

- (1) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Abdyl Matoshi", Kompleksi ICE, Don Bosko, Tiranë, Shqipëri
- (2) Adresa e faqes së internetit të shoqërisë është: [www.advision.al](http://www.advision.al)
- (3) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: [info@advision.al](mailto:info@advision.al).

**Kreu II**

**Kapitali**

**Neni 5**

**Kapitali themeltar**

- (1) Kapitali themeltar fillostar i shoqërisë është 10,000.00 Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
1. Ortaku themelues Enea Koka: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 3333.00 lekë që përbën 33.3 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
  2. Ortaku themelues Endri Karalli : Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 3334.00 lekë që përbën 33.4 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
  3. Ortaku themelues Grisilda Selfaj : Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 3333.00 lekë që përbën 33.3 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

**Neni 6**

**Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Rruga "Abdyl Matoshi", Kompleksi ICE, Don Bosko, Tiranë,  
Shqipëri | [info@advision.al](mailto:info@advision.al) | [www.advision.al](http://www.advision.al)

Faqja 3

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhë me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund ta detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlini i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

#### Neni 7

##### Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërnjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

#### KREU III

##### Organet Vendimmarrëse Dhe Drejtuese

#### Neni 8

##### Organi Vendimmarrës

Rruga "Abdy! Matoshi", Kompleksi ICE, Don Bosko, Tiranë,  
Shqipëri | [info@advision.al](mailto:info@advision.al) | [www.advision.al](http://www.advision.al)

Faqja 4

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin dhe shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pikë;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatijen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë r përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak jetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i Ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### Neni 9

##### Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e tu dërgohet të gjithë Ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpala datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### Neni 10

Kuorumi

Rruga "Aldyl Matoshi", Kompleksi ICE, Don Bosko, Tiranë,  
Shqipëri | info@advision.al | www.advision.al

Faqja 5

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonsbme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 përqind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur më lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

### Neni 11

#### Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tre të katërtat e votave të zotëruarve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve
- e) mbikëqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, përfshirë përgatijen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në proceset e tjera ndaj administratorëve;
- g) miratimin e rieggullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;
- h) çdo ndryshim statuti dñhet të depozitohet pranë QKB-së për të pasqruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

### Neni 12

#### Përashtimi nga e drejta e votës

1. Ortakët nuk mund të ushtrojnë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
  - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) shlyerjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqës i autorizuar, i autorizuar vlerësohet të jetë në të njëtin konflikt interesit, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### Neni 13

#### Administrimi

1. Asambleja e përgjithshme emëron z. Endri Karalli si administrator të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
2. Administratori e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të ketij ligji, nuk mund të emërohen si administrator të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. (Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm).
3. Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i shoqërisë deri në emërimin e tij nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.
4. Të dhënat e identifikimit: dhe specimenët e nënshkrimit:
  - Karalli Endri - Rr. "Abdyl Matoshi", Don Bosko, Tiranë, Shqipëri.  
(mbiemri, emri, adresa)

### Neni 14

#### Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqeson shoqërine tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- c) përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, si parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raporton përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- f) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori është i detyruar të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktiviteti i shoqërisë nuk i mbulon detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që

kanë vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

### Neni 15

#### Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

- I. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tervsi, duke i kushtuar vemendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesht;
  - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen nv ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - c) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
  - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes se detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, ne bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
  3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, është i detyruar t'i dëmshpërbleje shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyre solidare.
  4. Në mënyrë te veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen Ortakëve kontributet;
- b) u paguan Ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- c) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte astësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe demshpérblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e keresë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### Kreu IV

Viti finanziar-ekspertët

#### Neni 16

Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbylljet më 31 Dhjetor.

#### Neni 17

Ekspertët

Eksperi ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e Ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperi kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshtë i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë Ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka

## Kreu V

### Prishja -riorganizimi i shoqërisë

#### Neni 18 Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund te bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtarë për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- e) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar l apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër ".

Prishja e shoqërive tregtarë ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e astësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### Neni 19


### Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja


Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare".

#### Neni 20

### Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e

  
Rruga "Abdyl Matoshi", Kompleksi ICE, Don Bosko, Tiranë,  
Shqipëri | [info@advision.al](mailto:info@advision.al) | [www.advision.al](http://www.advision.al)

Faqja 10

## Kreu V

### Prishja -riorganizimi i shoqërisë

#### Neni 18 Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund te bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoflwar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- e) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar l apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “ Shoqëri në likuidim e sipër ”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e astësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### Neni 19

### Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”.

#### Neni 20

### Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e

legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 21**  
**Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lind midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

**ORTAKËT**

**E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

\* AdVision ALBANIA Sh.p.k.\*

**Enea KOKA**

(nënshkrimi)

**Endri KARALLI**

(nënshkrimi)

**Grisilda SELFAJ**

(nënshkrimi)